



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK PUKË

ANALIZA E PYETËSORIT NË LIDHJE ME PRIORITETET E PUBLIKUT
PËR PROJEKTBUXHETIN AFATMESEM 2024-2026

QËLLIMI I PYETËSORIT

Ky pyetësor ka si qëllim të mundësojë pjesëmarrjen qytetare në vendimarrje duke mbledhur mendimin e komunitetit mbi mënyrën sesi bashkia i ka shpenzuar paratë gjatë vitit 2022 si dhe të ndihmojë Këshillin Bashkiak të kuptojë së cilat janë prioritet kryesorë të komunitetit në lidhje me buxhetin afatmesëm 2024-2026. Pyetësori merr mendimin edhe në lidhje me performancën e shërbimeve kryesore. Bazuar në rezultatet e këtij pyetësori Këshilli Bashkiak Pukë do të hartojë një shkresë përcjellëse në lidhje me kërkesat prioritare të komunitetit për shpenzime buxhetore e cila mendohet të ndihmojë administratën e përcaktimin e taveveve përgatitore. Pyetjet bazohen në të dhënat faktike të vitit 2022.

Pyetësori është shpallur në faqen web të Këshillit Bashkiak dhe median sociale në datë 31 Janar 2023 dhe ka qëndruar online deri me datë 10 mars 2023.

REZULTATET E SONDAZHIT

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

55 persona kanë plotësuar pyetësorin nga njësi administrative të ndryshme, ndër të cilët dallohet që ka një shumicë të dallueshme të femrave me rreth 57%. Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve në pyetësor 55.7% vijnë nga yona urbane njësi administrative e Pukës, pra qendra e bashkisë dhe me pas njësi administrative Rrapë me 12.7%. Më pak pjesëmarrës ka patur nga njësitë administrative Gjogjan, Qelëz dhe Qerret me nga 9% pjesëmarrës. Të gjitha njësitë administrative janë të përfaqsuara nga antarë të komunitetit që kanë plotësuar këtë pyetësor. Për më shumë informacion shiko tabelat mëposhtë:

Përcaktoni gjininë tuaj
55 responses




Tabela 1: Gjinia e pjesëmarrësve

Përcaktoni rezidencën tuaj
55 responses





Tabela 2: Vendbanimi i pjesëmarrësve



Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve 54.5 % i përkasin grupmoshës 18-30 vjeç, pra janë të rinjtë shumica e pjesëmarrësve në këtë pyetësor çka tregon një lehtësi të madhe për të përdorur teknologjinë dhe angazhim më të madh të tyre në qeverisjen vendore. Më pas vijnë grupmoshat e tjera rreth 24% grupmosha 31-45 vjeç dhe 20% pjesëmarrës grupmosha 46-60 vjeç. Pjesëmarrësit vijnë nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Edhe këtu pjesa më e madhe rreth 30% janë të rinj studentë dhe vijon me të punësuarit ne administratën publike 27.8 %, të ndjekur më pas nga të papunët me rreth 17%, të vetëpunësuarit dhe të punësuarit në sektorin privat 13%. Për më shumë informacion shikoni tabelat mëposhtë:

Përcaktoni cilës grupmoshë i përkisni
55 responses



Unë jam (zgjidh nje nga opsionet)
54 responses





Tabela 3: Grupmosha e pjesëmarrësve

Tabela 4: Punësimi i pjesëmarrësve

MENDIMI I PJESËMARRËSVE NË LIDHJE ME SHPENZIMET BUXHETORE PËR SHËRBIMET KRYESORE

Sikurse vihet re nga grafiku në tabelën 5 ka një dakordësi të pjesëmarrësve për mënyrën se si shpenzohen paratë nga Bashkia në pothuajse të gjitha programet buxhetore. Megjithatë qytetarët pjesëmarrës në pyetësor kërkojnë nga bashkia që të ketë me shumë vemendje nga bashkia për shërbimet publike që ajo u ofron qytetarëve duke kërkuar nga bashkia që shpenzojë më shumë para. Më shumë para kërkohen të shpenzohen edhe për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe mbrojtjen civile. Për më shumë informacion te tabela 5.

A jeni dakort me mënyrën si janë shpenzuar paratë? Shprehni opinionet tuaja në lidhje me këtë.





PERCEPTIMI QYTETAR PËR PUNËN E BASHKISË

Sikurse vihet re nga grafiku në tabelën 6 ka një dakordësi të pjesëmarrësve për performancën e bashkisë. Pjesa më e madhe e qytetarëve janë të kënaqur në përgjithësi me punën e bashkisë për të gjitha shërbimet. Megjithatë sipas tabelës ka qytetarë që mendojnë se mund të punohet më mirë në disa shërbime si ai i Mbrojtjes nga zjarri, në Administrimin e pyjeve dhe në Shërbimet publike vendore. Për më shumë informacion te tabela 6.

Si e vlerësoni performancën e bashkisë për shërbimet kryesore të ofruara?




Tabela 6: Vlerësimi i qytetarëve për punën e Bashkisë

PRIORITETET E KOMUNITETIT NE LIDHJE ME BUXHETIN 2024

Sikurse duket në grafikun e tabelën 7, programet më prioritare për komunitetin, pra ata që qytetarët pjesëmarrës kanë zgjedhur 5 janë Mbrojtja e nga zjarri dhe mbrojtja civile, Administrimi i Pyjeve me nga rreth 35% të pjesëmarrësve, Trashigëmia dhe eventet artistike dhe kulturore dhe Mbështetje për zhvillimin ekonomik me rreth 30 % dhe Shërbimet publike dhe Rrjeti rrugor me afërsisht 25% të pjesëmarrësve.

Duket se qytetarët e shohin bashkinë e tyre si një bashki që mbron pyjet dhe mjedisin rreth e rrotull, pasi e ardhmja e tyre është zhvillimi ekonomik nëpërmjet promovimit të turizmit, trashigimisë kulturore dhe eventeve kulturore dhe artistike dhe të gjitha këto arrihen me shërbime publike cilësore dhe rrjet rrugor të mirë. Pra Bashkia, brenda mundësive duhet të vendosë më shumë burime financiare për të arritur qëllimet e mësipërme. Për më shumë informacion se si kanë votuar pjesëmarrësit e këtij pyetësi online ju lutem shikoni me kujdes rezultatet te tabela mëposhtë me nr.7.



Prioritetet e komunitetit

55 responses




Tabela 7: Prioritetet e komunitetit për buxhetin e vitit 2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË PUKË

Nr. 713 Prot.

D. 28/03/2023

Lenda: Rezultatet e Sondazhit të Prioriteteve të Komunitetit të Bashkisë Pukë

Drejtuar: z. Gjon Gjonaj, Kryetari i Bashkisë

Për dijeni: Anëtarëve të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Pukë

I nderuar zoti Kryetar,

Komisioni i Përhershëm i Ekonomisë dhe Buxhetit, i mbledhur me datën 27/03/2023, pasi shqyrtoi rezultatet e sondazhit të prioriteteve të komunitetit për Projektbuxhetin Afatmesëm 2024-2026 dhe me anë të kësaj shkrese kërkon reflektimin e kërkesave të qytetarëve që dalin nga sondazhi i organizuar nga Këshilli Bashkiak në buxhetin 2024 si pjesë e Projekt Buxhetit 2024-2026 brenda kapaciteteve dhe mundësive financiare dhe prioriteteve strategjike të Planit të Përgjithshëm Vendor. Komisioni kërkon që të rritet buxheti i bashkisë për:

1. Mbrotjen nga zjarri dhe mbrojtjen civile,
2. Administrimin e Pyjeve dhe Kullotave
3. Trashigëminë kulturore dhe eventet artistike dhe kulturore
4. Mbështetjen për zhvillimin ekonomik
5. Rrjetin rrugor
6. Shërbimet publike vendore,

Komisioni pret reagimin e Tuaj në lidhje me kërkesat e komunitetit.

Këtij dokumenti i bashkagjitet edhe dokumenti i analizes së sondazhit për përcaktimin e prioriteteve të komunitetit.

Kryetar i Këshillit Enver Sulejmani

Sekretari i Këshillit Edona Hysenaj

Kryetar Komisioni Ordue Loka

Sekretari i Këshillit

Edona Hysenaj

